

VENDIM
Nr. 106, datë 21.4.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “SPV BLUE 3” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1101/1 prot., datë 17.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 3’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “SPV Blue 3” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1101 prot., datë 8.4.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik “Blue 3”, me vendndodhje në Sheq Marinas, me kapacitet të instaluar 36 mwac, për një afat 30-vjeçar.

- Shoqëria ka kërkuar që afati 30-vjeçar të fillojë me operimin e veprës, pas kalimit të provës 72-orëshe të testimit dhe komisionimit nga “OST” sh.a. Sa kërkuar nga shoqëria vlerësohet se mbështetet dhe në marrëveshjen e zhvillimit të projektit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ku afati lidhet me datën e operimit tregtar apo kolaudimin e veprës, ndaj në rast licencimi të shoqërisë, afati i vlefshmërisë së licencës do të fillojë pas komisionimit nga “OST” sh.a.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në referencë të përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ka plotësuar dokumentacionin si vijon:

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1.

- Në përputhje me nenin 9, pikën 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “b” dhe “d”.

- Në përputhje me nenin 9, pikën 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germës “b”.

- Në përputhje me nenin 9, pikën 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencim në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “c”, “d” dhe “e”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Shoqëria “SPV Blue 3” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë “Marrëveshjen për zhvillimin e projektit, në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e impiantit fotovoltaiik ‘Blue 3’ me një kapacitet të instaluar prej 36 mwac dhe kapacitet të mbështetur prej 36 mwac që do vendoset në Sheq Marinas, Fier”, me nr. 6122/3 prot., datë 10.12.2024;

- Ka nënshkruar me Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. “Marrëveshjen për lidhjen në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaiik ‘Blue 3’”, me nr. 3508/6 prot., datë 24.10.2025;

- Është pajisur me VNM paraprake nr. AN090720250011, datë 29.10.2025, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Parku Fotovoltaiik – Blue 3”.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9. Format i dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “c”: Aplikuesi duhet të bëjë me dije nëse stafi i përcaktuar në strukturën organizative është aktualisht efektiv.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “a”: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- germa “c”: Aplikuesi duhet të japë informacionin/argumentet përkatëse mbi periudhën për të cilën janë bërë parashikimet në planin e biznesit dhe/ose depozitimin e planit të biznesit të përditësuar.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1

- germa “a”: Aplikuesi duhet të saktësojë kapacitetin e instaluar të njësive gjeneruese, si dhe të depozitojë garanci për panelet që do të përdorë, në rast se e disponon, në mënyrë që të rakordohen dhe afatet e vlefshmërisë së licencës;

- germa “b”: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE komunikimet me MIE-n, në lidhje me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta (SPV), të depozitojë në ERE qëndrimin e MIE-s (në rast se ka pasur një të tillë), si dhe të bëjë me dije në rast se e ka nënshkruar marrëveshjen përfundimtare dhe ta depozitojë atë në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 3” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik “Blue 3”, me kapacitet të instaluar 36 mwac, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 3” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për

gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti